



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Kuvendi i Komunës
Skupština Opština
Municipal Assambly

Drejtoria e Arsimit dhe Kulturës
04.Nr. 610/01-21366 /2020
Kaçanik, 31.08.2020

Në bazë të Ligjit për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës Nr. 04/L.032, Ligjin për Arsimin në Komunitet në Kosovës Nr.03/L-06 dhe rekomandimit të Inspektorëve të Arsimit të dhënë në dokumentin me Nr. 660/19 të datës 20.12.2019, me qëllim të ngritjes së cilësisë në arsim, Drejtoria e Arsimit dhe Kulturës merr këtë :

VENDIM

1. Për ndërprerjen e punës në SHFMU "Emin Duraku" paralelja e ndarë fizike në fshatin Gjurgjedell.
2. DKA siguron transportin e nxënësve deri në shkollën amë dhe anasjelltas.
3. DKA do të sistemojë të gjithë mësimdhënësit që janë me kontrata të përhershme dhe punëtorin teknik.
4. Drejtoria e shkollës është përgjegjëse për mirëmbajtjen e objektit shkollor dhe mund ta shfrytëzojë për punëtorin të ndryshme me nxënës apo për piknik.
5. Ky Vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Arsyetim:

Vendimi është marrë me qëllim të respektimit të rekomandimit të Inspektorëve të Arsimit dhe të ngritjes së cilësisë në arsim. Numri i vogël i nxënësve (vetëm 7 nxënës në vitin shkollor 2019-2020), ka imponuar mbajtjen e mësimin me klasa të kombinuara që ndikon drejtpërdrejt në kualitetin e mësimnxënies. Pasi që përgatitjet janë kryer më herët duke pasqyruar rekomandimin e Inspektorëve të Arsimit të dhënë në dokumentin me Nr. 660/19 të datës 20.12.2019, drejtoria e Arsimit dhe Kulturës, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Me këtë Vendim njoftohen: Kryetari i Komunës, Drejtoria e SHFMU "Emin Duraku" në Kaçanik dhe Arkiva.

Drejtori i Drejtorisë
z. Zahir Doda

